

Vendim nr.228, datë 03.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 03.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 19 (E) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ERION VELIAJ**, përfaqësuar nga avokati Plarent Ndrecaj, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 29, datë 09.02.2026 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Pavlefshmëria e të gjitha seancave të zhvilluara në lidhje me procedimin penal nr. 27/2024 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar pas datës së dhënies së vendimit nr. 29, datë 09.02.2026 të gjyqtarit të seancës paraprake.

Konstatimi i papajtueshmërisë me Kushtetutën të pikës 1 të nenit 332/gj të Kodit të Procedurës Penale.

Konstatimi i papajtueshmërisë me Kushtetutën i nenit 14 të ligjit nr. 95/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të subjektit të interesuar.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 31 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për**

organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji Organik i Gjykatës).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është zgjedhur kryetar i Bashkisë së Tiranës në zgjedhjet vendore të vitit 2023, si përfaqësues i subjektit politik të shumicës qeverisëse, Partisë Socialiste. Me vendimin nr. 66, datë 03.11.2025, Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) ka vendosur shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, e vendimit nr. 539, datë 25.09.2025 të Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë së Tiranës, zotit Erion Veliaj, për shkak të mosparaqitjes së tij në detyrë dhe të dekretit të Presidentit të Republikës nr. 350, datë 01.10.2025 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”.

2. Mbi bazën e materialit referues të Byrosë Kombëtare të Hetimit, të hartuar pas verifikimit të disa të dhënave me natyrë komprometuese për kërkuesin, të paraqitura nga një shtetas i vetidentifikuar si N.A., në një akt në formën e një kallëzimi penal me shkrim, në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) është regjistruar procedimi penal nr. 27 i vitit 2024 (*procedimi penal nr. 27/2024*) për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal (*KP*).

3. Pas hetimeve të kryera, Prokuroria e Posaçme ka pretenduar se provat e grumbulluara krijojnë dyshimin e arsyeshëm se bëhej fjalë për një sistem të organizuar korrupsioni dhe shpërdorimi të fondeve publike, të udhëhequr nga kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe bashkëshortja e tij dhe se në qendër të kësaj skeme korrupsioni dhe pastrimi të produkteve që burojnë nga veprimtaria kriminale dyshohet se është kërkuesi. Sipas organit të akuzës, nënshkrimi i tij ka qenë përcaktues për shpërndarjen e fondeve publike, prej të cilave ai dhe familjarët e ngushtë të tij dyshohet se kanë përfituar drejtpërsëdrejti në mënyrë të parregullt.

4. Në datën 27.12.2024, pasi janë konstatuar elemente që lidheshin edhe me vepra të tjera penale, në regjistrin e njoftimit të veprave penale janë shënuar edhe veprat penale sipas neneve 245, 287, paragrafi i dytë dhe 257/a, paragrafi i dytë, të KP-së. Në vijim, në datat 16.01.2025 dhe 24.01.2025, janë shënuar edhe veprat penale të parashikuara nga nenet 305/b dhe 301 të KP-së.

5. Në datën 24.01.2025 Prokuroria e Posaçme ka regjistruar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale emrin e kërkuesit si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, të parashikuara përkatësisht nga nenet 260 e 25 dhe 287, paragrafi i dytë, të KP-së. Po në atë datë, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit.

6. Me vendimin nr. 7 akti, datë 09.02.2025 (*vendimi nr. 7/2025*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), si i dyshuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 260 e 25 dhe 287, paragrafi i dytë, të KP-së. Sipas asaj gjykate, nga të dhënat konkrete të grumbulluara deri në këtë fazë të hetimit paraprak, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se kërkuesi ka kryer veprat penale për të cilat është proceduar penalisht. Kërkuesi dhe bashkëshortja e tij dyshohen se kanë kryer në bashkëpunim veprime të kundërligjshme që konsistojnë në marrjen e përfitimeve të parregullta në disa episode të veçanta, në formë shumash monetare dhe pasurish të paluajtshme nga shtetas ose subjekte tregtare, të cilat kanë pasur interesa të drejtpërdrejtë financiare në Bashkinë e Tiranës.

7. Pas ekzekutimit të masës së sigurimit në datën 10.02.2025, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar gjykatës me kërkesë për marrjen në pyetje të kërkuesit dhe verifikimin e kushteve e të kriterëve të zbatimit të masës së sigurimit. Me vendimin nr. 14, datë 12.02.2025 (*vendimi nr. 14/2025*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në burg”, të caktuar ndaj kërkuesit me vendimin nr. 7/2025 të po asaj gjykate, duke vlerësuar se nuk janë zbutur nevojat e sigurimit, pasi rrethanat e faktit nuk kanë ndryshuar për sa kohë gjykata ndodhej përpara të njëjtave veprime, sjellje dhe fakte të cilat janë vlerësuar një herë prej saj. Kundër vendimeve të mësipërme ka paraqitur ankim edhe kërkuesi.

8. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 13(87-2025-85), datë 13.03.2025, ka miratuar vendimin nr. 7/2025 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, i verifikuar me vendimin nr. 14/2025 të po asaj gjykate, me

të cilin është caktuar ndaj kërkuesit masa e sigurimit personal “Arresti në burg”, duke vlerësuar se ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova se kërkuesi ka konsumuar veprat penale që i janë atribuar. Ajo gjykatë e ka gjetur të drejtë vlerësimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë se asnjë masë tjetër sigurimi nuk do të ishte e përshtatshme për të garantuar nevojat e sigurimit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs edhe kërkuesi.

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1153(176), datë 08.07.2025, në dhomën e këshillimit, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja “e”, të KPP-së, ka lënë në fuqi vendimin e GJKKO-së së Apelit, duke vlerësuar se ai është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit penal (material dhe procedural).

10. Vendimet e mësipërme janë kundërshtuar nga kërkuesi në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) dhe në përfundim të këtij gjykimi, me vendimin nr. 57, datë 25.05.2026, Gjykata ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-1153 (176), datë 08.07.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në atë gjykatë. Gjykata ka gjetur shkelje të aspektit substancial të lirisë personale, në drejtim të *proporcionalitetit të masës së sigurimit personal* të lidhur edhe me të drejtën për t’u zgjedhur dhe në drejtim të *dinjitetit* të kërkuesit, për sa i përket mungesës së arsytimit nga Gjykata e Lartë në lidhje me këto pretendime kushtetuese të kërkuesit.

11. Në datën 10.09.2025 Prokuroria e Posaçme i është drejtuar GJKKO-së së Shkallës së Parë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 27/2024, duke ngritur ndaj kërkuesit akuzën për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të kryer në bashkëpunim (9 herë), “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë, “Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim”, më shumë se një herë, “Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga nenet 260 e 25, 287, paragrafi 2, 324/a, paragrafi 2, 257/a, paragrafi 2 dhe 248 të KP-së.

12. Me vendimin nr. 29, datë 09.02.2026, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke dërguar për gjykim procedimin penal nr. 27/2024, me të pandehur edhe kërkuesin, të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 260 e 25 të KP-së, në bashkëpunim, më shumë se një herë, 287, paragrafi i dytë, të KP-së, në bashkëpunim, më shumë se një herë, 324/a, paragrafi i dytë, të KP-së, më shumë se një herë, 257/a, paragrafi i dytë dhe 248 të KP-së. Në vlerësimin e asaj gjykate, nga aktet dhe provat që ajo i ka vlerësuar të mjaftueshme, rezultonte se kërkuesi dhe bashkëshortja e tij kanë kryer

në bashkëpunim veprime aktive të kundërligjshme, të cilat konsistojnë në marrjen e përfitimeve të parregullta në 9 episode të veçanta në formë shumash monetare, por edhe pasurish të paluajtshme nga shtetas ose subjekte tregtare që kanë pasur interesa të drejtpërdrejtë financiarë në Bashkinë e Tiranës. Sipas asaj gjykate, roli i kërkuesit lidhet me pagesat e bëra në adresë të shoqërive, të cilat, më pas, kanë kaluar shuma të hollash në favor të bashkëshortes së tij ose drejtpërdrejt në favor të organizatave jofitimprurëse (OJF) të kontrolluara prej saj. Këto shuma janë kanalizuar në vijim në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose persona fizikë e individë të kontrolluar nga bashkëshortja e kërkuesit, e cila ka zbatuar skemën korruptive me qëllim përfitime të parregullta që burojnë nga funksioni i bashkëshortit të saj, përfitime të parregullta që përfshijnë edhe pasuri të paluajtshme. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, gjatë ushtrimit të detyrës si kryetar i bashkisë kërkuesi ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit me të gjitha OJF-të që kanë qenë nën kontrollin faktik të bashkëshortes së tij, të cilat, për këtë shkak, nuk mund të përfitonin fonde publike nga Bashkia e Tiranës.

13. Në datën 15.04.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimit të GJKKO-së Shkallës së Parë që ka vendosur kalimin në gjyq të çështjes penale ndaj tij. Kërkesa, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 20.04.2026.

II

Pretendimet e kërkuesit

14. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

14.1. *Për sa i përket vendimit gjyqësor, cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

14.1.1. *Së drejtës së mbrojtjes*, pasi edhe pse është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme vendosja në dispozicion e të gjitha akteve dhe provave, ai dhe mbrojtësi i tij nuk kanë pasur njohje reale me aktet e fashikullit penal, nuk i kanë lexuar ato, për rrjedhojë nuk kanë qenë në gjendje t'i kundërshtojnë në mënyrë substanciale. Vendosja në dispozicion e materialeve në formatin elektronik (USB) nuk përmbush standardet e nenit 6 të KEDNJ-së, për shkak se kushtet objektive të paraburgimit nuk krijojnë mundësi reale për aksesim dhe studim të tyre në funksion të mbrojtjes. E drejta e mbrojtjes efektive nuk realizohet në mënyrë të deleguar, por kërkon pjesëmarrje personale të individit.

14.1.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, pasi sjellja e gjyqtarës gjatë seancës, refuzimi i kërkesave të mbrojtjes dhe pranimi

i qëndrimeve të prokurorisë krijojnë bindjen objektive se ajo nuk ka qëndruar në pozicion neutral, por është shndërruar palë në proces. Gjyqtarja, përmes sjelljes së saj, ka shfaqur arsye serioze njëanshmërie dhe paragjykimi. Mosdhënia e akteve kërkuesit në format të përdorshëm dhe caktimi i një afati jorealit për të shqyrtuar 60.000 faqe, jo vetëm nuk kanë ofruar garanci për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm, por përkundrazi kanë ndërtuar te kërkuesi bindjen objektive se ajo gjyqtare nuk ishte neutrale në çështjen e tij.

14.1.3. *Prezumimit të pafajësisë dhe dinjitetit njerëzor* për shkak të qëndrimit të kërkuesit në kafaz metalik gjatë seancave gjyqësore, çka ka kufizuar ndjeshëm mundësinë për të komunikuar lehtësisht me mbrojtësit, duke penguar përgatitjen e zhvillimin e mbrojtjes efektive. Kjo praktikë bie ndesh me nenin 6, pika 1, të KEDNJ-së dhe, për më tepër, e shoqëruar edhe me fotografimin e kërkuesit dhe publikimin e fotove në media, është dëshmi shtesë e cenimit të prezumimit të pafajësisë, për më tepër që kërkuesi nuk është akuzuar për një vepër të dhunshme, ka karakter të mirë dhe një pozitë të lartë shoqërore. Kjo situatë ka sjellë edhe dëmtimin e reputacionit të kërkuesit dhe familjes së tij.

14.2. *Për sa u përket dispozitave ligjore:*

14.2.1. *Pika 1 e nenit 332/gj të KPP-së* përjashton kontrollin gjyqësor të një vendimi që prek drejtpërdrejt pozitën procedurale të kërkuesit dhe shënon kalimin nga faza e hetimit në fazën e gjykimit në themel. Vendimi i seancës paraprake verifikon nëse akuza ka një minimum ligjshmërie, qartësie dhe mbështetjeje provuese për të justifikuar ekspozimin e individit ndaj gjykimit publik, pra kufizimi është absolut dhe nuk bën asnjë dallim sipas natyrës së shkeljes, nuk është proporcional dhe krijon pabarazi të pajustificuar brenda të njëjtës fazë procedurale. Ky ndalim absolut eliminon çdo mekanizëm kontrolli për cilësinë e arsyetimit të tij, duke i dhënë gjyqtarit të seancës paraprake pushtet vendimmarrës të pakontrolluar, që nuk i nënshtrohet asnjë verifikimi nga gjykatat më të larta.

14.2.2. *Neni 14 i ligjit nr. 95/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” (ligji nr. 95/2016)* cenon pavarësinë funksionale të gjyqtarit, sepse krijon një lidhje të papranueshme ndërmjet ushtrimit të funksionit gjyqësor dhe ekspozimit ndaj një autoriteti hetimor që është palë në proces.

Gjyqtari i seancës paraprake nuk mund të konsiderohet as i pavarur, as i paanshëm ndaj Prokurorisë së Posaçme për shkak të një raporti të qartë varësie institucionale që buron nga vetë kuadri ligjor në fuqi. Kjo kompetencë e Prokurorisë së Posaçme nuk gjen mbështetje në Kushtetutë dhe përbën zgjerim të pajustificuar të rolit të saj, duke e shndërruar nga palë procedurale në një autoritet me ndikim potencial mbi vetë trupin gjykues.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesit

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

16. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkesin. Po kështu, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Mbi këtë bazë, në vijim, Kolegji do të ndalet në verifikimin e kriterëve të legjitimitimit të *shterimit të mjeteve juridike efektive dhe ratione materia* të kërkesit.

17. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Detyrimin për përmbushjen e këtij kriteri Gjykata e ka vlerësuar si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur në themel procesin gjyqësor, ashtu edhe në rastin e vendimeve të ndërmjetme,

karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, që do të thotë se ajo mund të kërkohej vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individit ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Ky kriter përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili, përpara se t'i drejtohet Gjykatës, duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Qëllimi i kësaj dispozite kushtetuese është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Megjithatë, Kolegji vëren se në juridiksionin kushtetues janë përfshirë, në mënyrë përjashtimore, edhe vendimet gjyqësore të ndërmjetme, kur plotësohen këto kushte: (i) shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar, pra provohet se kërkuesi është viktimë e shkeljes të së drejtës kushtetuese; (ii) vendimi është bërë objekt i ankimit të veçantë dhe është shqyrtuar nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet e cenuar; (iii) vendimi ka një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Të tilla janë edhe vendimet për caktimin ose zëvendësimin e masave të sigurimit personal (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 13.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), ose ato për sekuestrimin e pasurive gjatë procedimit penal (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Përfshirja e këtyre vendimeve në kontrollin kushtetues është pranuar për shkak të pasojave që ato sjellin në të drejtat themelore të individit. Kjo lidhet me faktin se këto vendime kanë autonomi në raport me procesin gjyqësor të themelit, ku përcaktohet (pa)fajësia e personit dhe se cenimi i pretenduar i të drejtave substanciale buron drejtpërdrejt prej tyre.

20. Bazuar në sa më sipër, Kolegji vëren se objekt i ankimit kushtetues individual në shqyrtim është vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë që ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim edhe të kërkuarit, pra vendimi gjyqësor që i ka hapur rrugë gjykimit në themel të akuzave penale ndaj tij. Ky vendim nuk përcakton në mënyrë përfundimtare (pa)fajësinë e kërkuarit për kryerjen e veprave penale për të cilat ai është akuzuar dhe, për nga natyra e tij, nuk sjell një pasojë të drejtpërdrejtë, të menjëhershme dhe të pariparueshme në të drejtat themelore të tij. Edhe referuar pretendimeve të kërkuarit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt, Kolegji konstaton se ato kanë të bëjnë me aspekte të procesit gjyqësor që mund të ngrihen lirisht përpara gjykatave të zakonshme gjatë gjykimit të themelit të çështjes dhe u referohen të drejtave që mund të ushtrohen lirisht gjatë atij procesi përpara atyre gjykatave, të cilat, në përputhje me kompetencat e tyre, kanë edhe detyrimin që të garantojnë, më së pari, aspektet e një procesi të drejtë gjyqësor në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. Për rrjedhojë, kërkuari ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e të drejtave gjatë shqyrtimit të themelit të çështjes, ku ai mund të parashtojë pretendimet e tij, personalisht ose nëpërmjet mbrojtësit, në lidhje me akuzën, të paraqesë provat që i konsideron të nevojshme në mbështetje të pretendimeve të tij ose të kundërshtojë provat dhe pretendimet e akuzës, si dhe të paraqesë ankim në gjykatat më të larta, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

21. Për sa më sipër, në kushtet kur vendimi objekt kundërshtimi nuk konsiderohet përfundimtar për qëllime të gjykimit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vlerëson se nuk plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike në dispozicion, për rrjedhojë ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuari nuk mund të merret në shqyrtim.

22. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae* Kolegji vëren se kërkuari ka kërkuar edhe konstatimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të pikës 1 të nenit 332/gj të KPP-së, që nuk lejon ankimin kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq, si dhe të nenit 14 të ligjit nr. 95/2016, që parashikon kompetencën e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme që të hetojnë dhe ndjekin penalisht prokurorë ose gjyqtarë të posaçëm kur kanë dyshime të arsyeshme për kryerjen e një veprë penale. Për sa i përket kësaj të fundit, Kolegji vëren se Gjykata ka vlerësuar edhe më parë se rregullimet e dispozitave të ligjit nr. 95/2016 ofrojnë garanci të mjaftueshme kundër abuzimit dhe arbitraritetit në fazën e zbatimit të tyre, duke garantuar në këtë mënyrë edhe pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme. Sipas saj, kuadri ligjor në fuqi që rregullon statusin e magjistratit dhe të drejtat që burojnë prej tij, përmban një tërësi garancish ligjore dhe procedurale shtesë, të cilat sigurojnë pavarësinë e gjyqtarëve të posaçëm në ushtrim

të funksionit të tyre (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Kolegji vlerëson se në lidhje me këtë kërkim, nga njëra anë, kërkuksi nuk ka argumentuar në këndvështrimin kushtetues cenimin në të drejtat dhe liritë e tij themelore dhe, nga ana tjetër, ai është bërë objekt i një vendimi të mëparshëm të kësaj Gjykate, e cila e ka gjetur përmbajtjen e normës të pajtueshme me Kushtetutën. Për rrjedhojë, ai nuk mund të merret në shqyrtim.

23. Në lidhje me kërkimin për papajtueshmërinë me Kushtetutën të pikës 1 të nenit 332/gj të KPP-së, Kolegji vëren se ky kërkim, duke qenë se parashtrohet përpara Gjykatës në funksion të kërimit për shfuqizimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale të kërkuksit, i cili është një vendim jopërfundimtar, nuk mund të merret në shqyrtim. Kolegji, duke mbajtur në konsideratë se cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të parashikuara nga sistemi i zakonshëm i apeli meve, edhe kur procedurat gjyqësore paraprake sjellin një rëndim ose zgjatje të mëtejshme të cenimit të pretenduar (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*), vlerëson se kërkuksi mund t'i drejtohet eventualisht Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të kenë përfunduar shqyrtimin në themel të çështjes penale dhe të kenë dhënë një vendim përfundimtar. Për rrjedhojë, kërkimet e paraqitura nga kërkuksi në drejtim të pajtueshmërisë me Kushtetutën të dispozitave ligjore nuk mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues.

24. Për sa i përket kërimit për deklarimin e pavlefshmërisë të të gjitha seancave të zhvilluara pas dhënies së vendimit nr. 29, datë 09.02.2026, Kolegji vëren se kjo kompetencë u përket gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në përputhje me rregullat e KPP-së. Gjykata nuk ushtron kontroll të drejtpërdrejtë mbi vlefshmërinë procedurale të seancave gjyqësore, por kontrollon në instancë të fundit nëse aktet e pushtetit publik ose vendimet gjyqësore kanë cenuar të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese. Për më tepër, ky kërkim është i lidhur dhe i ndërruar nga kërkitimi për shfuqizimin e vendimit të seancës paraprake, i cili, për arsyet e mësipërme, nuk mund të merret në shqyrtim. Për rrjedhojë, edhe ky kërkim nuk mund t'i nënshtrohet shqyrtimit kushtetues.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuksit nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.